

PROCESVERBAL
nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele,
mbajtur më 26.6. 2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 20-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në ora 13:30 dhe u mbajt në hapësirat e Agjencisë, salla e konferencave, kati i dytë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratim i Propozim-procesverbalit nga seanca e 19-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 15.6.2023.
2. Propozim – vendim për rritjen e planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtjeje publike ndaj operatorit Total TV, për shkelje të nenit 141 nga LSHMAAV.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtjeje publike ndaj operatorit Total TV, për shkelje të nenit 143 nga LSHMAAV.
5. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar të seancës së 19-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, mbajtur më 15.6. 2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski e arsyetoi Propozim – vendimin për rritjen e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023. Ai sqaroi se javën e kaluar në Agjencion ka ardhur Kërkesë nga Këshilli për Etikë në Media të Maqedonisë për donacion financiar në vlerë prej 420.000,00 denarë. Sipas mundësive, ASHMA-ja është e gatshme të plotësojë këtë kërkesë, por jo me atë shumë të mjeteve, por me ndihmën prej 300.000,00 denarë. Për të mundësuar realizimin e këtij donacioni është e nevojshme të bëhet ndryshim i Planit Financiar të Agjencisë për vitin 2023 në mjete prej 300.000,00 denarë, sepse këtë vit për shkak të të dhënave për BPV (prodhim i brendshëm bruto) planifikohet të merren më shumë mjete nga kompensimi për lejet sesa që ishte planifikuar bazuar në BPV nga viti i kaluar.

Z. Petrushevski deklaroi se do ta mbështesë propozimin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për miratimin e rritjes së Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, nr. 05-2267/1 datë 30.5.2023.

Të ardhurat (hyrat) dhe shpenzimet totale të planifikuara sipas Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023 do të rriten për 300.000,00 denarë, përkatësisht do të arrijnë në shumë prej 149.830.505,00 denarë.

Rritja e propozuar do të sigurojë mjete financiare në vlerë të përgjithshme prej 300.000,00 denarë, destinuar për:

- Dhënie të ndihmës financiare - Donacion për Këshillin për Etikë në Media të Maqedonisë, sipas Kërkesës së tyre nr. 122-0302 të datës 19.6.2023 (Nr,y në ark. 05-2536/1 datë 20.6.2023), me të cilën është kërkuar donacion nga Agjencia për të mundësuar funksionimin normal të Zyrës Ekzekutive dhe Komisionit të Ankesave.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pikat 3 dhe 4

Z. Petrushevski lidhur me shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj operatorit Total TV, për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe për shkelje të nenit 143 të LSHMAAV, propozoi që për Pikat 2 dhe 3 të bëhet një hyrje dhe diskutim dhe më pas për secilën prej tyre të votohet veçmas.

Z. Trajçevski sqaroi se gjatë mbikëqyrjes së rregullt është konstatuar se operatori TOTAL TV e ritransmeton shërbimin programor "Telma", i cili nuk është i përfshirë në çertifikatën e regjistrimit të shërbimeve programore, të dhënë nga Agjencia. Për këtë arsye i sugjerohet Këshillit të shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV. Ai informon se ndërkohë pra pas mbikëqyrjes së kryer, operatori e ka çertifikuar (regjistruar) këtë shërbim programor, por duke qenë se tashmë është konstatuar shkelje, propozohet vërejtje publike. Lidhur me Pikën 4, ai shpjegoi se këtë shkelje TOTAL TV e kryen vazhdimisht prej disa vitesh. Edhe pse sipas LSHMAAV është i obliguar që të gjitha shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv t'i ritransmetojë, ai sërish nuk kryen ritransmetimin e shërbimeve programore të "MRT 2", "MRT 3", "MRT 4" dhe "MRT 5", që bie në kundërshtim

me nenin 143 paragrafi (3) të LSHMAAV. Duke qenë se kjo mbikëqyrje është e para në këtë vit, propozohet që të shqiptohet masë paralajmërim publik.

Votimi për pikën 3

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e krye të rregullt programore, nr.11-2558/ 1 të datës 21.6.2023 dhe njëzëri konstatoi se ndaj operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik Shoqërisë për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr. 01-4139/1 të datës 7.11.2022 e ka udhëzuar menjëherë pas pranimit të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizojë punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, e cila sipas notifikimit (njoftimit) të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të kryejë veprimtarin në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbim programor "Telma", e cila nuk mbulohet me çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore, të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, e cila bie në kundërshtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike duhet të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për operatorin në fjalë.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-2559/1 të datës 21.6.2023 dhe njëzëri konstatoi se ndaj Shoqërisë për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 143 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprimin sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 7.11.2022 e ka udhëzuar menjëherë pas pranimit të aktvendimit për vërejtje publike të harmonizojë punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, e cila sipas notifikimit (njoftimit) të Agjencisë për Komunikime Elektronike mund të kryejë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në paketën e tij programore nuk ka ofruar shërbime të shërbimit publik radiodifuziv, gjegjësisht nuk kryen ritransmetim të shërbimeve programore "MRT 2", "MRT 3", "MRT 4" dhe "MRT 5", që bie në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (3) të LSHMAAV.

Spektori për çështje juridike duhet të hartojë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike për operatorin në fjalë.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për paralajmërim publik të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-2575/5

12.07.2023

Shkup

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**